



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 20035 Prot

Lezhë, më 20 / 12 /2022

VENDIM

Nr. 132, Datë 20. 12.2022

Për një shtesë e ndryshim në Buxhetin e Bashkisë Lezhë për vitin 2022 dhe përdorim të Fondeve të Rindërtimit.

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjes Vendore”; të ligjit nr.68, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; të Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”; dhe shkresave të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.22884/1, 22885/1 dhe 22892/1, datë 14.12.2022 “Mbi zbatimin e VKM nr.790, nr.791 dhe nr.798, datë 12.12.2022”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë,

Vendosi :

1. Miratimin e një shtese dhe ndryshimi në buxhetin e Bashkisë Lezhë për vitin 2022, si më poshtë:

1/1-Të shtohen burimet në buxhetin e vitit 2022 në shumën 321,600,000 lekë, fonde të akorduar me VKM nr.790, nr.791 dhe nr.798, datë 12.12.2022.

1/2-Të shtohen shpenzimet në shumën 321,600,000 lekë. Për këtë të kryhen veprimet si më poshtë:

- Pakësohet :
 - Gr.00, Prog.04960, Kap.01, Art.604 në shumën 321,600,000 lekë.
- Shtohet :
 - Gr.00, Prog.08220, Kap.01, Art.231 në shumën 197,600,000 lekë, për këto objekte: a.Për rihforcimin e Pallatit të Kulturës “Dedë Ndue Lazri” në shumën 104,000,000 lekë dhe b.Për rihforcimin dhe rikonstruksionin e Bibliotekës “Gjergj Fishta” në shumën 93,600,000 lekë.
 - Gr.00, Prog.09240, Kap.01, Art.231 në shumën 124,000,000 lekë, për objektin: Për rihdërtimin e Konviktit të Shkollës së Mesme Profesionale “Kolin Gjoka”, Lezhë në shumën 124,000,000 lekë.

2.Për zbatimin e këtij vendimi ngakohet Kryetari i Bashkisë.

3.Ky vendim hyn fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI

FLORIDA ÇUNAJ

KRYETARI

NDUE LULI



Nr. 20039/1 Prot.
Dt. 20.12.2022



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PREFEKTI I QARKUT LEZHË
SEKTORI JURIDIK

Nr. 938/3 Prot.

Lezhë, më 20.12.2022

Lënda: Konfirmim vendimi

KËSHILLIT TË BASHKISË LEZHË

Për Dijeni : KRYETARIT TË BASHKISË LEZHË

Bazuar në nenin 16 pika 2 gërma "b" të ligjit Nr.107/2016, datë 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", ligjin nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ligjin nr.68, datë 27.04.2017 "Për financat e Vetëqeverisjes vendore", ligjin nr.9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" të ndryshuar VKM-në nr.790 datë 12.12.2022 "Për një shtesë në vendimin nr. 1034, datë 16.12.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për përdorimin e fondit të rindërtimit për rirforcimin e pallatit të kulturës 'Dedë Ndue Lazri', në bashkinë Lezhë" VKM-në nr 791, datë 12.12.2022 "Për një shtesë në vendimin nr. 910, datë 18.11.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rindërtimit të konviktit të shkollës së mesme profesionale 'Kolin Gjoka', bashkia Lezhë dhe caktimin e bashkisë Lezhë si njësi zbatuese", konfirmoj bazueshmërinë ligjore të vendimit nr.132, datë 20.12.2022 të këshillit të bashkisë Lezhë "Për një shtesë e ndryshim në buxhetin e bashkisë Lezhë për vitin 2022 dhe përdorim të fondeve të rindërtimit".

P R E F E K T I

Gjergj PRENDI

